AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Nr. 925 Prot., Tiranë më 12. 10.2026

URDHËR

Nr. 219, datë 12. 10.2026

"PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KOMUNIKIMIN PUBLIK DHE PËRFAQËSIMIN E INSTITUCIONIT NË VEPRIMTARITË JASHTË ZYRËS"

Në mbështetje të nenit 60, pika 2, dhe nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, si dhe të Rregullores së Brendshme të institucionit,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Rregullores "Për komunikimin publik dhe përfaqësimin e institucionit në veprimtaritë jashtë zyrës", sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e kësaj rregulloreje i gjithë stafi i institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

Endrit SHABANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr. 2, Tiranë Tel/Fax +355 4 2380 300/315; E-mail. ap@avokatipopullit.gov.al; www.avokatipopullit.gov.al

RREGULLORE
PËR KOMUNIKIMIN PUBLIK DHE PËRFAQËSIMIN E INSTITUCIONIT NË VEPRIMTARITË JASHTË ZYRËS

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për komunikimin publik të institucionit të Avokatit të Popullit, për prezantimin e institucionit si dhe për pjesëmarrjen e funksionarëve dhe punonjësve të institucionit në veprimtari jashtë zyrës, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të garantojë unitetin e qëndrimit institucional, koordinimin e përfaqësimit të jashtëm, mbrojtjen e konfidencialitetit të ankuesve dhe të çështjeve në shqyrtim, si dhe respektimin e transparencës dhe hierarkisë ligjore për çdo veprimtari publike që kryhet në emër të institucionit.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë personat që ushtrojnë funksione ose punojnë në institucionin e Avokatit të Popullit: komisionerët, ndihmëskomisionerët, nëpunësit civilë, përfaqësuesit vendorë të caktuar sipas nenit 32 të ligjit, si dhe ekspertët dhe personat e kontraktuar, për sa kohë veprojnë në emër dhe për llogari të institucionit.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Komunikim publik" është çdo deklaratë, prononcim, intervistë, publikim, prezantim ose mesazh që i drejtohet publikut, medias, institucioneve të tjera ose organizatave, me çfarëdo mjeti apo mediumi komunikimi, përfshirë rrjetet sociale.

b) "Qëndrim institucional" është çdo vlerësim, rekomandim, koment apo opinion që paraqitet si qëndrim i institucionit të Avokatit të Popullit për një çështje të caktuar.

c) "Veprimtari jashtë zyrës" është çdo konferencë, forum, tryezë, seminar, trajnim, takim me institucione, organizata ose partnerë, vizitë studimore, mision ose veprimtari tjetër që zhvillohet jashtë ambienteve të institucionit ose në formë virtuale me pjesëmarrës të jashtëm.

ç) "Veprimtari me përfaqësim institucional" është veprimtaria në të cilën personi paraqitet, prezantohet ose perceptohet si përfaqësues i autorizuar i Avokatit të Popullit.

d) "Veprimtari me cilësi personale" është veprimtaria në të cilën personi merr pjesë në emrin e vet dhe është e qartë se nuk po vepron në emër dhe për llogari të institucionit.

dh) "Ftesë institucionale" është ftesa që i drejtohet institucionit, Avokatit të Popullit si titullar, ose një seksioni a strukture të institucionit.

e) "Ftesë personale" është ftesa që i drejtohet me emër një funksionari ose punonjësi të institucionit dhe nuk lidhet me funksionin që ai ushtron në institucion.

ë) "Autorizim" është miratimi me shkrim i Avokatit të Popullit, i dhënë me shkresë, urdhër ose me postë elektronike institucionale, për një veprim të caktuar ose për një kategori veprimesh.

f) "Kabineti" është Kabineti i Avokatit të Popullit, si strukturë koordinuese sipas kësaj rregulloreje.

Neni 5
Parimet

Komunikimi publik dhe përfaqësimi i jashtëm i institucionit udhëhiqen nga parimet e unitetit të qëndrimit institucional, të pavarësisë dhe paanësisë politike, të ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave të ankuesve sipas nenit 12 të ligjit, të saktësisë së informacionit, si dhe të transparencës sipas ligjit për të drejtën e informimit.

KREU II

QËNDRIMET INSTITUCIONALE DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Neni 6
Shprehja e qëndrimit institucional

1. Qëndrimi institucional i Avokatit të Popullit shprehet vetëm nga Avokati i Popullit ose nga personi i autorizuar prej tij për çështjen ose kategorinë e çështjeve përkatëse.
2. Askush nuk mund të paraqesë si qëndrim institucional një pozicion që nuk është miratuar nga Avokati i Popullit ose që nuk përmbahet në akte të miratuara dhe të publikuara të institucionit si raporte, rekomandime ose deklarata publike.

Neni 7
Marrëdhëniet me median

1. Marrëdhëniet me median ndiqen nga struktura përgjegjëse për komunikimin, e cila është pika e vetme e kontaktit për kërkesat e medias.

2. Çdo kërkesë e medias që i drejtohet një funksionari ose punonjësi i përcillet strukturës përgjegjëse për komunikimin brenda ditës së marrjes. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vetëm kërkesat që trajtohen sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Deklaratat për shtyp, njoftimet publike dhe qëndrimet e institucionit për median miratohen nga Avokati i Popullit para publikimit.
4. Intervistat, prononcimet dhe pjesëmarrja në emisione bëhen nga Avokati i Popullit ose nga personi i autorizuar prej tij. Autorizimi mund të jetë i veçantë për një rast ose i përgjithshëm për një fushë ose një lloj çështjesh.
5. Komisionerët dhe drejtuesit e strukturave mund të autorizohen në mënyrë të përgjithshme për të komunikuar me publikun në emër të institucionit, përmes medias tradicionale ose rrjeteve sociale, për çështje teknike dhe procedurale të fushës që mbulojnë, brenda qëndrimeve të miratuara të institucionit.

Neni 8
Publikimet dhe faqja zyrtare

1. Materialet që publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe në kanalet zyrtare të institucionit miratohen nga Avokati i Popullit ose nga personi i autorizuar prej tij dhe administrohen nga struktura përgjegjëse për komunikimin.
2. Publikimi i akteve të institucionit që kërkohet nga ligji për të drejtën e informimit kryhet sipas programit të transparencës.

Neni 9
Rrjetet sociale

1. Llogaritë zyrtare të institucionit në rrjetet sociale, si dhe faqja zyrtare në internet administrohen vetëm nga struktura përgjegjëse për komunikimin, e cila ndihmohet nga specialistët e teknologjisë së informacionit për aspektet teknike të menaxhimit të tyre.
2. Në llogaritë personale, funksionarët dhe punonjësit nuk flasin në emër të institucionit, nuk publikojnë informacion për çështje në shqyrtim, për ankues ose për dokumente të brendshme, dhe nuk komentojnë qëndrime të institucionit që nuk janë bërë ende publike.
3. Personat që në llogaritë personale identifikohen me funksionin që ushtrojnë në institucion respektojnë detyrimin e paanësisë politike dhe të ruajtjes së imazhit publik të institucionit.
4. Të gjithë punonjësit e Avokatit të Popullit ndjekin rregullat e Kodit të Etikës së institucionit në komunikimet e tyre në rrjetet sociale.

Neni 10
Konfidencialiteti

Në çdo komunikim publik dhe në çdo veprimtari jashtë zyrës ruhet fshehtësia e identitetit të ankuesve, përveç rasteve kur ata kanë kërkuar ose kanë dhënë pëlqimin e tyre për të kundërtën. Në çdo rast respektohet legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, sipas rastit, ai për informacionin e klasifikuar.

KREU III

PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI ZYRTARE

Neni 11
Klasifikimi i veprimtarive

1. Veprimtaritë ku marrin pjesë punonjësit e institucionit klasifikohen në veprimtari me përfaqësim institucional dhe veprimtari me cilësi personale.
2. Konsiderohen veprimtari me përfaqësim institucional:

a) konferencat, tryezat dhe forumet ku punonjësit e institucionit marrin pjesë;

b) takimet me institucione publike, organizata ndërkombëtare, misione diplomatike, rrjete të ombudsmanëve dhe organizata joqeveritare;

c) misionet faktmbledhëse, inspektimet në terren dhe vizitat studimore;

d) pjesëmarrja në intervista mediatike ose emisione televizive;

e) çdo veprimtari tjetër ku personi prezantohet me titullin e funksionit që mban në institucionin e Avokatit të Popullit.

3. Në rast dyshimi për klasifikimin e një veprimtarie, punonjësi kërkon orientimin e Kabinetit të Avokatit të Popullit para pranimit të ftesës dhe konfirmimit të pjesëmarrjes.

Neni 12
Ftesat drejtuar institucionit

1. Ftesat institucionale, me çfarëdo mjeti që të vijnë, i përcillen Kabinetit të Avokatit të Popullit brenda ditës së marrjes së tyre.
2. Avokati i Popullit vendos për pjesëmarrjen dhe cakton përfaqësuesin e institucionit, duke marrë parasysh fushën e veprimtarisë dhe propozimin e strukturës përkatëse.
3. Funksionarët dhe punonjësit e institucionit i pranojnë dhe konfirmojnë ftesat për përfaqësim institucional vetëm pasi marrin miratimin e Avokatit të Popullit. Ky miratim mund të jetë i shprehur ose i heshtur, sipas Nenit 13, pika 4.

Neni 13
Ftesat personale për veprimtari me përfaqësim institucional

1. Funksionari ose punonjësi që merr një ftesë personale për një veprimtari me përfaqësim institucional njofton me shkrim Kabinetin e Avokatit të Popullit jo më vonë se pesë ditë pune para veprimtarisë, ose menjëherë pasi merr dijeni, kur ftesa vjen më vonë se ky afat.
2. Njoftimi bëhet sipas formatit tip dhe përmban ftesën, organizatorin, datën dhe vendin, temën dhe formatin e pjesëmarrjes, rolin që i kërkohet personit, si dhe masat e nevojshme për pjesëmarrje (si transporti ose shpenzime të tjera).

3. Avokati i Popullit, brenda tre ditëve pune nga marrja e njoftimit, mund të autorizojë pjesëmarrjen, të caktojë përfaqësues tjetër të institucionit, të kërkojë përputhjen e prezantimit me qëndrimet e miratuara, ose të vendosë që institucioni të mos përfaqësohet në veprimtarinë përkatëse.
4. Nëse brenda afatit të pikës 3 nuk jepet përgjigje, pjesëmarrja konsiderohet e autorizuar, me detyrimin e respektimit të neneve 6, 15 dhe 17 të kësaj rregulloreje.

Neni 14
Veprimtaritë me cilësi personale

1. Veprimtaria akademike, e mësimdhënies dhe autoriale ushtrohet në përputhje me ligjin dhe me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave.
2. Personi që merr pjesë në veprimtari akademike, kur veprimtaria lidhet me fushën e të drejtave të njeriut ose me veprimtarinë e institucionit, njofton paraprakisht Kabinetin e Avokatit të Popullit. Veprimtaria mësimdhënëse rregullohet sipas ligjit dhe kërkon miratimin me shkrim të titullarit.
3. Në veprimtaritë me cilësi personale, personi deklaron qartë se flet në emrin e vet, nuk përdor simbolet dhe materialet e institucionit, nuk komenton çështje në shqyrtim dhe nuk paraqet pozicione si qëndrime të institucionit.

Neni 15
Përmbajtja e prezantimeve institucionale

1. Prezantimet, fjalimet dhe materialet që paraqiten në emër të institucionit i dërgohen Kabinetit të Avokatit të Popullit jo më vonë se dy ditë pune para veprimtarisë.
2. Të dhënat statistikore dhe gjetjet që paraqiten publikisht janë vetëm ato të miratuara ose të publikuara nga institucioni.
3. Propozimet për politika, ndryshime ligjore ose qëndrime të reja të institucionit paraqiten publikisht vetëm pas miratimit nga Avokati i Popullit.

Neni 16
Raportimi pas veprimtarisë

1. Brenda dy ditëve pune nga përfundimi i çdo veprimtarie me përfaqësim institucional, pjesëmarrësi i dërgon Kabinetit një raport të shkurtër sipas formularit tip, i cili përmban: organizatorin dhe pjesëmarrësit kryesorë në veprimtari, temat e trajtuara, përmbledhjen e diskutimeve dhe qëndrimeve të paraqitura, angazhimet ose kërkesat e diskutuara në lidhje me Avokatin e Popullit, si dhe veprimet e propozuara për ndjekje të mëtejshme.
2. Kabineti mban regjistrin e veprimtarive të jashtme dhe i raporton Avokatit të Popullit çdo muaj për veprimtaritë e kryera dhe angazhimet në ndjekje.

Neni 17
Angazhimet në emër të institucionit

Marrëveshjet e bashkëpunimit, deklaratat e përbashkëta, anëtarësimet në rrjete ose organizma, mbështetja publike e nismave të palëve të treta dhe çdo angazhim tjetër që lidh institucionin bëhen vetëm nga Avokati i Popullit ose me autorizim të veçantë të tij.

Neni 18
Paanësia politike

1. Ndalohet pjesëmarrja në emër të institucionit në veprimtari të partive politike, në fushata zgjedhore ose në veprimtari me karakter partiak, si dhe në çdo veprimtari tjetër që mund të cenojë imazhin e pavarësisë dhe paanësisë së institucionit.
2. Gjatë periudhës zgjedhore, çdo komunikim publik i institucionit dhe çdo pjesëmarrje në veprimtari publike vlerësohet me kujdes të shtuar dhe autorizohet në mënyrë të veçantë nga Avokati i Popullit.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE ZBATIMI

Neni 19
Roli i Kabinetit dhe i strukturës së komunikimit

1. Kabineti koordinon ftesat, njoftimet, autorizimet dhe raportet sipas kësaj rregulloreje, duke mbajtur regjistrin e ftesave dhe regjistrin e veprimtarive të institucionit.
2. Kabineti përgatit çdo javë kalendarin e veprimtarive me pjesëmarrje të institucionit dhe ua shpërndan Avokatit të Popullit, komisionerëve dhe Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Struktura përgjegjëse për komunikimin mbështet pjesëmarrësit me materiale, të dhëna të miratuara dhe mesazhe kyçe të institucionit.

Neni 20
Autorizimet

1. Autorizimet jepen me shkrim. Komunikimi me postë elektronike institucionale konsiderohet formë e shkruar.
2. Autorizimi mund të jetë i veçantë, për një veprimtari ose komunikim të caktuar, ose i përgjithshëm, për një fushë, një lloj veprimtarish ose një periudhë të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm përcakton kufijtë e tij dhe mund të revokohet në çdo kohë.
3. Autorizimi nuk e çliron personin nga detyrimet e neneve 6, 10, 15 dhe 17.

Neni 21
Mosrespektimi i rregullores

Mosrespektimi i kësaj rregulloreje dokumentohet nga Kabineti dhe i raportohet Avokatit të Popullit, i cili kërkon shpjegime me shkrim dhe merr masat organizative brenda kompetencave të tij, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22
Marrëdhënia me aktet e tjera

Kjo rregullore nuk kufizon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta dhe ligji, nuk cenon të drejtën e informimit publik për aktet e institucionit dhe zbatohet në harmoni me Rregulloren e Brendshme të institucionit.